

Nr.	Titulli	Donatori	Viti Aplikimit	Periudha e zbatimit	Permbledhje
1	Improving Belsh Municipality integrated services for sustainable tourism	IADSA II	Maj 2023	2024-2026	Ky projekt ka për qëllim të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm afatgjatë të turizmit në nivel kombëtar, duke balancuar aspektet mjedisore, ekonomike dhe socio-kulturore. Në mënyrë të veçantë, ai synon të nxisë turizmin aktiv përmes ndërtimit të infrastrukturës dhe faciliteteve moderne e të sigurt, të cilat do të ndihmojnë në promovimin e integruar të destinacioneve turistike dhe në zhvillimin e shërbimeve konkurruese në fushën e turizmit e mikpritjes, duke krijuar mundësi punësimi për gratë dhe të rinjtë.
2	Evaluating Vulnerabilities and Optimizing Local Vitality and Ecosystems in Belsh	CLIMAAX Consortium	Tetor 2024	2025-2027	EVOLVE-Belsh është një projekt që synon të vlerësojë rreziqet klimatike dhe të zhvillojë strategji përshtatjeje për Bashkinë Belsh, duke përdorur metodologjinë CLIMAAX. Projekti fokusohet në përmbytjet, shirat e dendur, rrëshqitjet e dheut dhe ngjarjet ekstreme të motit, duke përmirësuar menaxhimin e rrezikut në sektorët e bujqësisë, zhvillimit urban dhe turizmit. Ai gjithashtu forcon kapacitetet institucionale dhe bashkëpunimin lokal për zbatimin e masave të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike.
3	EU4Digital	Bashkimi Evropian dhe Qeveria Federale e Republikës së Gjermanisë	2025	2024-2027	Projekti WiFi4WB synon të ofrojë internet falas dhe të qëndrueshëm në hapësira publike si sheshe, parqe e institucione, duke përmirësuar ndjeshëm lidhjen digjitale dhe aksesin në informacion për qytetarët, në kuadër të përpjekjeve të Bashkimit Evropian dhe Qeverisë Gjermane përmes GIZ për të nxitur integrimin e Ballkanit Perëndimor në Tregun Digjital të BE-së.
4	Sunny Schools	Open Society Foundations - Western Balkans (OSF-WB)	Korrik 2025	2025-2026	“Sunny Schools”, ka për synim kryerjen e një investimi me qëllim instalimin e impianteve fotovoltaike (prodhim energjie elektrike përmes energjisë diellore), duke përfshirë funksionimin dhe mbarëvajtjen në ndërtesat e shkollave 9-vjeçare publike “Halit Uruçi”, Shkolla Seferan dhe Shkolla Dragot.